

Komuna e Kaçanikut/Kaçanik

Hetem (Mustafë) Zeqiri

(1947, shqiptar nga Hani i Elezit/Đeneral Janković, komuna e Kaçanikut/Kaçanik)

Hetemi ka jetuar vetëm në shtëpi në Han të Elezit/Đeneral Janković. Ishte i sëmurë nga epilepsia dhe jetonte nga pensioni i invaliditetit. Në datën 22.03.1998, Hetemi shkoi te vëllai Abdullahu në lagjen *Dushkajë/Duškaja* në **Kaçanik/Kaçanik**. Aty e kaloi natën dhe të nesërmen, më **23.03.1998**, u nis për në shtëpi. Ishte kjo hera e fundit kur Abdullahu e shihte atë të gjallë, sepse nga kjo ditë Hetemit i humbet çdo gjurmë. Zhdokja e tij nuk është evidentuar në dokumentet e KNKK-së. Familjarët edhe më tutje janë duke tentuar ta ndriçojë fatin e Hetemit.

Burimi: deklarata A.Z, FDH-19804.

Bajrush (Bedri) Tafli

(18.05.1958, shqiptar nga Kaçaniku/Kaçanik, vozitës, një fëmijë)

Bajrushu mori pjesë më **2.05.1998** në marshin protestues në **Kaçanik/Kaçanik** kundër pushtetit serb. Pas përfundimit të protestës, Bajrushu i nis për në shtëpi dhe afër shtëpisë së mallrave e takoi Mahmut Dardhishtën, kryetar i Këshillit komunal të SPS-it në Kaçanik/Kaçanik. Aty mes tyre shpërtheu një përlëshje për arsye politike, që u pasua me kacafytje, ndërsa më pas Mahmuti e nxori revolen dhe shtiu mbi Bajrushin, duke e plagosur rëndë. Bajrushin së pari e dërguan në ambulancën e qytetit dhe, më pas, në spitalin e Prishtinës/Priština. Në rrugë për në Prishtinë/Priština, Bajrushu ndërroi jetë nga plagët e shkaktuara. Familja e

ka varrosur më 3.05.1998 në varrezat në Kaçanikut/Kaçanik.

Burimet: deklarata N.T, FDH-20926; ICTY, IT-02-54 (S. Milošević), EX.312.52, FDH-30993; KMDLNI, *Buletini*, num. 7, prill-qershor 1998, 114, FDH-23816; KKMKRFJ, *Personat.*, FDH-10832.

Agim (Qerkin) Bajrami

(12.02.1964, shqiptar nga Stagova/Stagovo, komuna e Kaçanikut/Kaçanik, pjesëtar i UÇK)

Xheladini (Miftar) Kurtaj

(20.4.1976, shqiptar nga Gabrica, komuna e Kaçanikut/Kaçanik, aktor, pjesëtar i UÇK-së)

Besnik (Liman) Begunca

(21.07.1972, shqiptar nga Kaçaniku/Kaçanik, pjesëtar i UÇK-së)

Agimi që nga shkolla e mesme ishte politikisht i angazhuar kundër regjimit serb. Mori pjesë në demonstratat e vitit 1981. Gjatë shërbimit ushtarak në Armatën Popullore të Jugosllavisë [APJ], në vitin 1988, është dënuar me pesë vjet burgim, për shkak të aktiviteteve të tij politike. Është liruar në vitin 1991, dhe menjëherë u largua për në Zvicër. Në mars të vitit 1998, aderoi në UÇK. Xheladini ishte aktor, ka mbaruar Akademinë e Artit, dega e aktrimit. Në UÇK aderoi në muajin maj të vitit 1998. Besniku aderoi në UÇK më 4.08.1998. Në datën **10.08.1998**, në mëngjes, rreth orës 05:00, Agimi, Besniku dhe Xheladini gjendeshin në shtëpinë e Xheladinit në **Gabricë/Gabrica**, kur papritur i rrethoi policia serbe. Në shkëmbim zjarri ndërmjet dy grupeve, Agimi, Xheladini dhe Besniku u vranë, ndërsa një polic u plagos. U varrosën të nesërmen në varrezat e fshatit